

Nr. 2289 Prot.,

Tiranë, më 15.12.2023

UDHËZIM

PËR

**ZBATIMIN E PARIMEVE PËR MATJEN E ÇMIMEVE DHE VËLLIMEVE NË
LLOGARITË KOMBËTARE¹**

Nr. 1, datë 15.12.2023

Bazuar në ligjin nr. 30/2022 “Për miratimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”, neneve 17/4 dhe 20/b të ligjit nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare”, VKM nr. 122, datë 01.03.2023 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025”, me qëllim krijimin e kuadrit rregullator për përcaktimin e parimeve për matjen e çmimeve dhe volumeve në llogaritë kombëtare

UDHËZOHJ:

1. Llogaritë për matjen e çmimeve dhe volumeve në kuadër të prodhimit të statistikave të Llogarive Kombëtare, të kryhen në përputhje me parimet e Aneksit 1 dhe Aneksit 2 këtij udhëzimi.
2. Planifikimi dhe zbatimi i Aneksit 1 dhe Aneksit 2 të këtij udhëzimi të pasqyrohet në Planin Vjetor përkatës për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, me synim rritjen e nivelit të përputhshmërisë me kërkesat e Rregullores së Këshillit (KE) Nr. 2223/96 mbi “Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Komunitet” amenduar nga Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, Nr. 549/2013 “Mbi Sistemin Evropian të Llogarive” (ESA 2010-eng);
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor për zbatimin e këtij Udhëzimi.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të INSTAT-it.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

ELSA DHALLI



¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me:

1. Rregulloren (KE) Nr. 2223/96 të datës 25.06.1996 “Për sistemin evropian të llogarive kombëtare dhe rajonale në Komunitet”
2. Vendimin e Komisionit Nr. 98/715/EC i datës 30 nëntor 1998 që sqaron aneksin A të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 2223/96 mbi “Sistemin Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale në Komunitet” lidhur me parimet për matjen e çmimeve dhe vëllimeve”
3. Vendimin e Komisionit Nr. 2002/990/EC i datës 17 dhjetor 2002, duke sqaruar më tej Aneksin A të Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 2223/96 lidhur me “Parimet për matjen e çmimeve dhe vëllimeve në llogaritë kombëtare”